



MARRËVESHJE PËR MIRËKUPTIM DHE BASHKËPUNIM

E lidhur më dt. 27.01 2023 në Obiliq ndërmjet:

1. Komunës së Obiliqit të cilën e përfaqëson Kryetari i Komunës së Obiliqit Z.Xhafer Gashi dhe
2. OJQ-së Banimi Social dhe të Drejtat Pronësore në Kosovë të njohur me shkurtesën angleze SHPRK (Social Housing and Property Rights in Kosovo) të cilën e përfaqëson Drejtori Ekzekutiv Agron Beka .

Neni 1 - Qëllimi

Qëllimi i kësaj Marrëveshje për Mirëkuptim dhe Bashkëpunim (MMB) është që përmes nënshkrimit të saj, Komuna e Obiliqit dhe OJQ SHPRK, obligohen që të bashkëpunojnë dhe koordinojnë veprimet që do të ndërmarrin lidhur me mbështetjen dhe lehtësimin e ndërsjellë nga të dyja palët për projekte të përbashkëta nga të cilat përfitojnë banorët e Komunës së Obiliqit.

Neni 2 –Obligimet e SHPRK-së

1. SHPRK synon të sigurojë fonde nga USAID – i për vitet ardhshme 2023-2026 për juristë të cilët do të ofrojnë ndihmë juridike falas për të gjithë banorët e kësaj komune.
2. SHPRK do të aplikojë edhe tek organizata të tjera ndërkombëtare dhe vendore për sigurimin e fondeve për realizimin e projekteve të ndryshme me interes të përgjithshëm.
3. SHPRK do të përfshijë zyrtarët e Drejtorive përkatëse në grupin e interesit në të gjitha projektet që do të realizohen në Komunën e Obiliqit.
4. SHPRK-ja, pasi të jetë ftuar, obligohet të marrë pjesë në mbledhjet e organizuara nga komuna ku diskutohen çështjet të ndryshme në interes të përbashkët.
5. SHPRK merr përsipër të informojë Komunën për aplikime për projektet që do t'u dërgohen donatorëve të ndryshëm, dhe qëllimi i të cilave është zbatimi në komunën e Obiliqit.

Neni 3 –Obligimet e Komunës së Obiliqit

1. Komuna do të sigurojë kushte minimale për punën e zyrtarit të SHPRK-së zyrë (ose një tavolinë në kuadër të një zyreje të përbashkët me stafin tjetër të komunës) karrige, tavolinë, kompjuter dhe qasje në printer dhe internet;
2. Komuna duhet të sigurojë hyrjen e papenguar të zyrtarit të cekur në pikën 1 të kësaj marrëveshjeje , në ndërtesën e komunës pasi të kenë treguar kartën e identifikimit (ID) të SHPRK-së;
3. Komuna do t'i japë SHPRK-së informacion se drejtoritë që janë të involvuara me projektet e SHPRK-së janë të informuara lidhur me projektet dhe se këto drejtori do t'u japin përparësi kërkesave të SHPRK-së kurdo që të jetë e mundur;
4. Pas nënshkrimit të kësaj MMB, konsiderohet se Komuna i ka dhënë pëlqimin SHPRK-së për të aplikuar për projekte të reja që do të zbatohen në Komunën e Obiliqit.

Neni 4 –Zgjidhja e mosmarrveshjeve

Në rast të mosmarrveshjeve të mundshme palët nënshkruese të MMB-s do të mundohen t'i zgjidhin ato me mirëkuptim, përndryshe do të vepohet sipas ligjeve në fuqi.

Neni 5 – Hyrja në fuqi dhe ndryshimi

MMB hyn në fuqi me nënshkrimin nga të dyja Palët dhe mbetet në fuqi deri më 31 Dhjetor 2026, me mundësi vazhdimi ,MMB mund të ndryshohet dhe plotësohet me pëlqimin reciprok në formë të shkruar nga të dyja Palët.

Neni 6-kopjet e nënshkruara

Ky MMB është përpiluar në 6 (gjashtë) kopje origjinale nga 3 (tri) kopje për secilën pale.


Agron Bekar
Drejtori Ekzekutiv
SHPRK




Xhafer Gashi
Kryetari
Komuna e Obiliqit

